



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR.10/3, DATË 05.12. 2016

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT PORO VLORË

Në mbështetje të Nenit 9, 17 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8, 10, e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues Poro, Vlorë, me subjekt investues Millenium International NUIS/NIPT:L41411035H, në procedurën e asistuar, për shkaqe që lidhen me verifikimin e kushteve të ardhshme, pasi legjislacioni i ri për zonat e mbrojtura, i cili do të rregullojë funksionimin e sistemit të zonimeve të brendshme për zhvillimin e turizmit, është në proces hartimi.
2. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në regjistrin e investimeve strategjike dhe i njoftohet, me shkrim, kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTËR I FINANCAVE
ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MILVA EKONOMI

MINISTËR I BUJQËSISË ZHVILLIMIT URBAN DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
EDMOND PANARITI

MINISTËR I MJEDISIT
LEFTER KOKA

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SOKOL DERVISHAJ

ZËVENDËS MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIËS
ILIR BEJTJA

ZËVENDËS MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN
GJON RADOVANI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ALMA HICKA